


REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTERIA E DREJTESISE
 DHOMA E NOTERISE SHKODER

Nr. rep 24 08 Nr. kol 1358
 Kontrata leke 3.000
 Pulla takse (arshive) 700
 Shuma leke 3.700

KONTRATE SHITBLERJE
PASURIJE TE LUAJTESHME

50 % TE KUOTAVE TE SHOQERISE "VLLAZNIMI" sh.p.k.



Në Dhomen e Noterise Shkodër, dhe para meje noter **Arben Salim Koplaku**, me seli ne rrugen "Dos Bosko", prane Gjykates se Faktit, sot me date 27 Shtator 2006(dymije e gjashte), te merkuren, u paraqiten personalisht palët e poshtëshenuara kontraktuese:.....

SHITES : Ylvi Sabri Mashu, dtl. 15 Dhjetor 1952, lindur e banues ne Shkoder, lagja "Qemal Stafa", Bulevardi "Zogu I-re", prane Bibliotekes "M. Barleti", nr. 29.

BLERES : Agron Shaban Okaj, dtl. 18 Shtator 1953, lindur e banues ne Shkoder, lagja "Manush Alimani", Bulevardi "Zogu I-re", pall. 327.....

Per identitetin e te cileve jam i njohur personalisht, madhore e me te gjithete aftesite e kerkuara nga ligja, sipas kerkeses se tyre, redaktova kete kontrate shitje pasurije te luajteshme - transferim kuotash (50 %, 75.000 leke), sipas kushteve te percaktuarar dhe te pranuarra prej tyre, si poshte vijon :

NENI 1. Objekti i kontrates.

Kjo kontrate ka si objekt transferimin te kuotave te Shoqerise "Vllaznimi" shpk, rregjistruar ne Gjykatën e Tiranës me :

- Vendim nr. 4645 date 1 Qershor 1994, ne favorin e z.z. 1. Ylvi Mashu, 2. Ylli Llapi, dhe 3. Sali Haxhagiq.
- Vendim nr 4645/1 date 1995, ne favorin e 1. Ylvi Mashu, dhe 2. Ylli Llapi.

- Vendim nr. 4645/1 7688 date 2 Shkurt 2001, duke kaluar e gjithë Shoqëria me administrator dhe ortak të vetëm z. Ylvi Mashi, ku në momentin e realizimit të këtij aktit të transferimit vlera reale e kuotave në pronësi të kësaj Shoqërie është 150.000 leke, të barazvlefshme me 100 % të kuotave, këto dhe sipas vendimit të Ortakut të vetëm të kësaj Shoqërie, me nr. 33 date 27 Shtator 2006....

NENI 2. Menyra e realizimit të transferimit.

Palet bien dakord që 50 % (75.000 leke) të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë të kalojnë në pronësi të blerësit, me anë të kësaj kontrate shitjeje të këtyre kuotave, kundrejt një kundërshtërimi të barazvlefshëm me vlerën reale të këtyre kuotave në momentin e lidhjes së kontratës, duke u bërë kështu që të të dy, z.z. 1. Ylvi Mashi, dhe 2. Agron Okaj, ortakë dhe bashkeadministratore të Shoqërisë "Vllaznimi" sh.p.k., Shkoder, secili me nga 50 % (75.000 leke) të kuotave të kapitalit themeltar....

NENI 3. Vendi, data dhe menyra e realizimit të pagesës.

Shlyerja e çmimit të kuotave të shoqërisë është bërë me anë pagimi me para në dorë cash shitesit në ambientet e selisë së kësaj Shoqërie.....

NENI 4. Detyrimet e paleve kontraktuese.

Pala blerëse e kuotave të kapitalit të Shoqërisë "Vllaznimi" ka paguar vlerat monetare sipas parashikimeve të nenit 2 të kontratës në datën, vendin dhe mënyrën e parashikuar në nenin 3 të kësaj kontrate, duke marrë persiper të gjithë drejtat dhe detyrimet dhe ndaj të tretëve, që të dy së bashku, secili me nga 50%.

NENI 5. Rregjistrimi.

Rregjistrimi i kësaj kontrate shitjeje do të bëhet në rregjistrin tregtar të Gjykatës së Tiranës.....

NENI 6. Zgjidhja e mosmarreveshjeve.

Te gjithë mosmarreveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate, të zgjidhen me pajtim nga palet.....

Ne rast pamundesi zgjidhje paqesisht dhe me marreveshje te paleve, kompetente do te jete Gjykata e Tiranes.

NENI 7. Dispozita te ndryshme


Per çdo gje te paparashikuar ne kete kontrate, palet i referohen legjislacionit shqiptar ne fuqi.....

Aktit i bashkelidhet dhe vendimet e sipertreguare te Gjykates se Tirane, dhe certifikata tatimore, e Deges se Tatim Taksave ne Shkoder, me Kodin Fiskal nr. 3.352.253.....


Kjo kontratë, e cila permban tre faqe, pasi u lexua me zë të lartë para palëve kontraktuese, të cilët, duke u gjetur konform kërimit dhe vullnetit të tyre të plotë, në prezencen time, e pranuan atë, dhe e nënshkruan si poshte rezulton:.....

Palët kontraktuese

Shitës

Ilir Mashri


Blerës

Agnes Oker


Arben Salim Kopliku
 Noter

